



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013
Nr.ref.:RK496/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI80/13

Parashtrues

Raim Gashi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 33/2013, të 30 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Raim Gashi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Fazli Balaj, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 33/2013, të 30 prillit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 17 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 33/2013, që pretendohet se është nxjerrë në shkelje të "[...] dispozitave të procedurës penale, neni 403, paragrafi 1, pika 8 dhe 12 i Kodit Penal të Kosovës [...]". Parashtruesi nuk ka specifikuar se cilat dispozita kushtetuese të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 5 korrik 2013, Gjykata kërkoj nga parashtruesi dokumentet shtesë:
 - a. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 33/2013, të 30 prillit 2013;
 - b. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, AP. nr. 304/2010, të 27 qershorit 2012;
 - c. Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 212/2009, të 19 marsit 2010; dhe
 - d. Autorizimin.
8. Më 15 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet e kërkuara.
9. Më 11 shtator 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
10. Më 18 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 22 mars 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 212/2009) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 244.1 [Falsifikimi i parasë] në lidhje me nenin 23 [Bashkëkryerja] dhe nenin 328.2 [Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, KPPK). Parashtruesi i kërkesës u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme.
12. Më 27 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. nr. 304/2010) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Gjykata Supreme konstatoi se *“Bazuar në atë që u tha më sipër si dhe në rrethanat dhe arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, Gjykata Supreme vlerësoi se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar gjendjen faktike drejt dhe në mënyrë të plotë dhe drejt ka aplikuar edhe ligjin penal kur i ka shpallur fajtorë të akuzuarit për veprën penale falsifikimi i parave nga neni 244 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, prandaj i refuzoi si të pabazuara ankesat për këtë bazë ankimore.”* Parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
13. Më 30 prill 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 33/2013) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme gjeti se *“[...],. –pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara. Shkeljet e pretenduara nga ana e mbrojtësit të të gjykuarit nuk janë të bazuara, sepse, bazuar në shkresat e lëndës, policët (...) ishin dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve pasi që ata kanë marrë pjesë në bastisjen e shtëpive të të akuzuarve (...), dhe ata kanë deklaruar lidhur me rrjedhën dhe sendet e gjetura gjatë bastisjes, ndërsa ushtrues të kallëzimit penal kanë qenë (...) - hetuesit që kanë paraqitur kallëzimin penal, (...) - mbikëqyrës i drejtpërdrejtë, (...) - shef i hetimeve të përgjithshme dhe (...) - shef i hetimeve rajonale, pra policët/dëshmitarët nuk janë ushtrues të kallëzimit penal dhe dëshmia e tyre është në përputhje me dispozitën e nenit 158 par. 1 të KPPK-së dhe shkelja e pretenduar e dispozitës së nenit 403 par. 1 pika 8 të KPPK-së është e pabazuar.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi pretendon se *“[...] dy aktgjykimet, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, P. nr. 212/2009, i 19 marsit 2010, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 304/2010, i 27 qershorit 2012, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 403, paragrafi 1, pika 8 dhe 12 i KPPK-së, të cilat janë të natyrës absolute. Të dy aktgjykimet bazohen në prova të papranueshme – nuk është vërtetuar identiteti i klientit tim – pasi që ai nuk është kryes i veprës penale. Janë bërë edhe shkelje të ligjit penal, me faktin se ai u shpall fajtor dhe u dënua për një vepër, të cilën nuk e ka kryer dhe për të cilën nuk ka asnjë provë në shkresat e lëndës. I tërë aktgjykimi fillon dhe përfundon me një grup njerëzish në Ferizaj, dhe pastaj bashkëngjitet pa asnjë bazë edhe i akuzuari Raim Gashi, i cili fare nuk ka të bëjë me këta të akuzuar.”*

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatë, i cili parasheh se *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”*
17. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36.1.c të Rregullores së punës të Gjykatës, i cili parasheh se *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse (...) kërkesa është qartazi e bazuar.”*
18. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit, përveç dhe për atë që ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Pra, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës[DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
19. Si përmbledhje, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991).
20. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka mbështetur dhe dëshmuar pretendimin si dhe pse gabimet e pretenduara të fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), të bëra nga Gjykata e Qarkut dhe Supreme mund të kenë shkelur ndonjë të drejtë ose liri të mbrojtur me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata më tej konsideron se pretendimi i parashtruesit se aktgjykimet e këtyre gjykatave ishin marrë në shkelje të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, është vetëm i natyrës së ligjshmërisë dhe jo i kushtetutshmërisë.
21. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
22. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës nuk e ka ndërtuar dhe dëshmuar rastin në shkelje të ndonjë të drejte të tij të garantuar me Kushtetutë. Kështu, në pajtim me rregullin 36.1.c të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe prandaj është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën, dhe në pajtim me rregullin 36.1.c dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 18 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani